

34

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

VENDIM

Numer 4 Date 07.05.2012

“Per

Miratimin e Lejes per shfrytezim materjalesh inerte ne shtratin e lumit Kir
Subjektit “DELIA GROUP” me administrator Viktor Delia”.

Ne mbeshtetje te neneve 8 , 20, 47 te ligjit Nr.8093, date 21.03.1996 “ Per rezervat ujore “ i ndryshuar, vendimit te K.K.U.-se nr. 1 dt. 07.07.2011 “Per menaxhimin e shfrytezimit te zhavoreve per ndertimin e rrugeve “, kontrates me objekt ndertimi rruga by pass Perendimor Shkoder loti 2 me nr.5311/4 date 30.11.2011 nenshkruar ne mes Drejtorise se Pergjithshme te Rrugeve dhe operatorit “DELIA GROUP” sh.p.k., dhe listes per shfrytezimin e inerteve lumore nr. 615/1 prot dt. 14.02.2012 te M.P.P.T., Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune

VENDOSI :

1. Miratimin e lejes per shfrytezim materjalesh inerte ne shtratin e lumit Kir, Subjektit “Delia Group” sh.p.k. me administrator Viktor Delia me qellim ndertimin e rruges by pass Perendimor Shkoder Loti 2.

Siperfaqja e shfrytezimit 0.1 km².

Koordinatat e shfrytezimit te zones jane si me poshte :

X – 1 - 4660000 , 2- 4660000, 3- 4661000, 4- 4661000.

Y – 1- 4378500, 2- 4378600, 3- 4378650, 4- 4378750.

Z - 1- 15.7, 2- 15.5, 3- 16.5, 4- 16.8.

2. Sasia e volumit te materialit te nxjerrshem do te jete 200.000 m³.

3. Afati i lejes do te jete 30.05.2013.

4. Ngarkohet per kontrollin e ketij vendimi AUB dhe INUK Shkoder.

PERGJEGJESI I A.U.B. DRIN-BUNE

KRYETARE E K.B.U. DRIN-BUNE

Muhamet MUÇA

Voltana ADEMI